



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Nr. 31

Datë: 29. 03. 2021. Ora: 10:30

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Valdete Daka, kryetare e KQZ - së.

Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Sami Hamiti, Arianit Elshani, Alim Rama, Eshref Vishi, Ibrahim Selmanaj, Gordana Llaban, Rifat Krasniq, Čemailj Kurtiši, Artan Asllani.

SKQZ: Burim Ahmetaj, kryeshef.

ZRPPC: Yll Buleshkaj, drejtor.

Përkthyes: Argjina Misini

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

RENDI I DITËS

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së;
 - Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbaleve të mbledhjes së KQZ-së Nr.23, 24 dhe 25/2021.
2. Aktivitetet e SKQZ-së:
3. Raporti i Këshillave të KQZ-së:

- **Këshilli për Çështje Ligjore;**

Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për zëvendësimin e anëtarëve të Kuvendit Komunal në Viti.

4. Të ndryshme.

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së:

Valdete Daka: E hapi mbledhjen, a ka dikush ndonjë propozim. Unë, propozoj një pikë të re: “Shqyrtimi i vendimit për shkuarjen në Shqipëri”. Duke marrë parasysh që kemi edhe një aktgjykim të Gjykatës Kushtetuese, presim të na dorëzohet sot...Unë, kisha kërkuar shqyrtimin...tonë! Ky, është propozim imi. Miratohet...s’i pikë shtesë...

Në përgjithësi, miratohet rendi i ditës.

2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbaleve të mbledhjes së KQZ-së Nr.23, 24 dhe 25/2021.

Miratohe me vërejtje të z. Alim Rama, Sami Hamiti, Eshref Vishi, Valdete Daka, Qemal Kurteshi, Burim Ahmetaj dhe Arianit Elshani: Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbaleve të mbledhjes së KQZ-së nr.23, 24 dhe 25/2021.

Miratohe...

3. Aktivitetet e SKQZ-së

Burim Ahmetaj: E keni pasur raportin e Sekretariatit në imell, dhe unë mund të përgjigjem në pyetjet eventuale...

Sami Kurteshi: Ju lutem, nëse mundeni me i na i dërgua më herët në mënyrë që t’i lexojmë raportet, sepse përndryshe, duhet raportuar këtu, në mbledhje...

Alim Rama, shtroi pyetje lidhur me asgjësimin e materialit zgjedhor 2007 – 2009 ?

Burim Ahmetaj, tha se materiali zgjedhor është në asgjësim e sipër nga java e kaluar, dhe se do të përfundoj së shpejti, dhe se deri më datën 2 prill do të lirohet edhe depoja dhe materialet do të kthehen në QNR. Brenda 3-4 ditëve, do të kompletohet procesi i asgjësimit të materialit zgjedhorë...

Valdete Daka: Secili material që parashkruhet, nuk mund të kërkohet nga askush, kështu që duhet asgjësuar materiali edhe i 2010! Në momentin që kanë kaluar 10 vite nga dita e zgjedhjeve, bëhet parashkrimi absolut i ndjekjes penale... Edhe të 2011-es, janë brenda parashkrimit dhe, duhet të asgjësohen...

Sami Kurteshi: Mos të nxjerrim probleme të kota! Një jurist i mirë, merr përgjegjësi në bazë të Kodit Penal dhe ligjeve në fuqi...Sekretariati, e ka këtë punë...

4.Raporti i Këshillave të KQZ-së

Këshilli për Çështje Ligjore

Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për zëvendësimin e anëtarëve të Kuvendit Komunal në Viti:

Arianit Elshani: Këshilli për Çështje Ligjore i ka shqyrtuar dy kërkesa për zëvendësim nga komuna e Vitisë. Për të dy kërkesat, dokumenti është në rregull dhe ne, i kemi shqyrtuar me përpikëri dhe, rekomandojmë të bëhen zëvendësimet.

Valdete Daka: Kush është për që Bajram Sokoli nga subjekti politik Lëvizja “Vetëvendosje!”, të e zëvendësojë anëtarin e deritashëm të kuvendit komunal, Nijazi Isakun.

Miratohet.

Valdete Daka: Kush është për që Lindita Demelezi nga subjekti politik Lëvizja “Vetëvendosje!”, të e zëvendësojë anëtarin e deritashëm të kuvendit komunal, Mirlinda Sadikun.

Miratohet.

Valdete Daka: Jemi në pritje të aktgjykimit, dhe besoj e marrim sot. Ne si KQZ, duhet ta shohim me kujdes, sepse aty thuhet që “retroaktivitet” nuk ka...! Megjithatë, ne kemi deputet që nuk e kanë dhënë betimin ende...Janë rekomandue nga KQZ për zëvendësim, por të njëjtit sipas këtij aktgjykimi ma nuk ju takon të jenë deputet për shkak të numrit të votave, jo për shkak të kuotës gjinore...

Marrja e këtij aktgjykimi, ka implikime. Ne, është mirë të jemi këndej pari, dhe ky udhëtim në Shqipëri të zëvendësohet apo, të mbahet në Kosovë...

Sami Kurteshi: Aktgjykimi ka një përfundim që nuk kthen mbrapa çështjet, por ka implikime financiare, kandidatët kanë të drejtë me paditë shtetin...Pra, thotë se “ka qenë interpretim i gabuar i ligjit edhe nga KQZ, PAZP dhe Gjykata Supreme”... Vec i gabueshëm edhe diskriminues, dhe kjo thuhet shprehimisht...

Një tjetër, aktgjykimi nuk ka të bëjë me deputetët që kanë dhënë apo s’kanë dhënë betim, ka të bëjë me certifikimin e deputetëve... Pyetja që ka shkuar në Gjykatë Kushtetuese, ka të bëjë me certifikimin...

Në këtë pikë, diskutuan shkurtimisht edhe: Alim Rama, Eshref Vishi.

5.Shqyrtimi i vendimit për ndryshimin e vendit të mbajtjes së punëtorisë së KQZ-së

Valdete Daka: Kam qenë prej fillimit që punëtorja të mbahet në Kosovë.

Alim Rama: Kërkesa ka qenë me e gjete një vend të përshtatshëm për shkak të masave të covidit në Kosovë, e nëse jo...

Eshref Vishi: Mendoj se administrata ju ka referue një praktike! Nisur nga praktika, këto takime janë mbajtur në vend të caktuar për arsye të ndryshme, edhe teknike...Organizimet këtu në Kosovë, nuk e kanë pasur efikasitetin e duhur...

Në këtë pikë, diskutuan edhe: Arianit Elshani, Sami Kurteshi, Artan Asllani, Yll Buleshkaj (ZRPP), Sami Hamiti dhe, Gordana Llaban.

Në fund, u vendos që punëtorja të mbahet sipas vendimit paraprak: në Shqipëri.

